



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Seancë plenare e Kuvendit

P- 041

Prishtinë, më 17 tetor 2008, në orën 12:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 17 TETOR 2008**

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Eqrem Kryeziu**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 82 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Kryetarja e Komisionit për Ekonomi, Tregti dhe Industri, Myzejene Selmani, propozoi që pika e pestë të hiqet nga rendi i ditës.

Kuvendi miratoi propozimin e deputetes Selmani që Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për akreditim të hiqet nga rendi i ditës së kësaj seance.

Kryetari i Grupit Parlamentar, **Ramë Buja**, propozoi që Kuvendi, duke u mbështetur në Rezolutën të Këshillit të Evropës, nr 148, datë 25 janar 2006, me të cilën ftohen vendet që t'i dënojnë krimet komuniste në ish botën e lindjes, ta autorizojë Komisionin për Legjislacion dhe

Gjyqësi që ta hartojë tekstin e një Projektrezolutive, me të cilën dënohen krimet e komunizmit në Kosovë, prej vitit 1945 deri në vitin 1999, dhe t'ia paraqesë Kuvendit për miratim.

Kryetari kërkoi deklarinimin e grupeve parlamentare lidhur me propozimin e Grupit parlamentar të PDK-së.

Sabri Hamiti, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Ibrahim Makolli**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Ardian Gjini**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së dhe **Gani Geci**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deklaruan se mbështesin nismën e Grupit parlamentar të PDK-së.

Kryetari hodhi në votim propozimin e Grupit parlamentar të PDK-së. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----shumica absolute,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

1. Ngarkohet Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi që ta hartojë tekstin e Projektrezolutës kundër krimeve të komunizmit në Kosovë prej vitit 1945 deri në vitin 1999.
2. Projektrezoluta t'i paraqitet Kuvendit për miratim në seancën e ardhshme.

Deputeti **Fatmir Rexhepi** propozoi që pika e 9-të të shtyhet për seancën tjetër të radhës, me arsyetimin se nuk ka informacion të mjaftueshëm nga ana e Qeverisë për propozimet që ia ka paraqitur Kuvendit.

Kryetari kërkoi deklarinimin e grupeve parlamentare lidhur me propozimin e deputetit Rexhepi.

Përfaqësuesit e grupeve parlamentare deklaruan se mbështesin propozimin e deputetit Rexhepi.

Kryetari hodhi në votim propozimin e deputetit Fatmir Rexhepi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----53,
Kundër-----11,
Abstenime-----10.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, vendosi që shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me propozimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Trustit Pensional të Kosovës të shtyhet për seancën e ardhshme plenare.

Pastaj, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d i t e:

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare, të mbajtura më 3 dhe 10 tetor 2008,
2. Koha për pyetje parlamentare,

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për masat antidamping,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për bujqësi dhe zhvillim rural,
5. Shqyrtimi dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbështetje ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nr. 02/L-5,
6. Shqyrtimi dytë i Projektligjit për Noterinë,
7. Miratimi i Rekomandimeve të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor,
8. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për revizionin e brendshëm, nr. 02/L-74,
9. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për zbritjen e tarifës menaxhuese,
10. Njoftimi i grupeve parlamentare të LDK-së dhe të AKR-së për ndërrimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare.

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare, të mbajtura më 3 dhe 10 tetor

Kuvendi miratoi pa vërejtje procesverbalet e seancave plenare, të mbajtura më 3 dhe 10 tetor 2008.

Deputetja **Gjylnaze Syla** kërkoi që të korrigjohet diskutimi i saj në transkript lidhur me propozimin për nxjerrjen e një rezolute. (Transkripti është korrigjuar sipas kërkesës së deputetes Syla).

2. Koha për pyetje parlamentare

Për shkak të pyetjeve të shumta që ishin parashtruar për këtë seancë (43), Kryetari propozoi që deputetët fillimisht të parashtrojnë vetëm nga një pyetje për Kryeministrin ose për ministrat e Qeverisë së Kosovës, pastaj nëse premtori koha, mund t'i parashtrojnë edhe pyetje të tjera.

Kuvendi miratoi propozimin e Kryetarit.

Deputetja **Gjylnaze Syla** i parashtroi pyetje Kryeministrit të Kosovës lidhur me informimin e Qeverisë së Kosovës për bisedimet e PSSP-së, Lamberto Zanieri me ministrin e Qeverisë së Serbisë Goran Bogdanoviq.

Kryeministri **Hashim Thaçi** iu përgjigj pyetjes së deputetes Syla.

Deputeti **Arsim Rexhepi** i parashtroi pyetje Kryeministrit të Kosovës lidhur me ndërtimin e një përkujtimoreje për Komandantin legjendar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jashari.

Kryeministri **Hashim Thaçi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Rexhepi.

Deputetja **Nurishahe Hulaj** i parashtroi pyetje Kryeministrit të Kosovës lidhur me veprimet e Qeverisë së Kosovës për zbatimin e Ligjit për duhanin.

Kryeministri **Hashim Thaçi** iu përgjigj pyetjes së deputetes Hulaj.

Deputeti **Riza Smaka** i parashtroi pyetje ministrit të Shëndetësisë lidhur me dhënien e certifikatave shëndetësore për shoferët dhe klientët që nuk janë në gjendje të mirë shëndetësore.

Ministri **Alush Gashi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputetja **Luljeta Shehu** i parashtroi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale lidhur me pensionet e familjeve të personave të pagjetur.

Ministri **Nenad Rashiq** iu përgjigj pyetjes së deputetes Shehu.

Deputetja **Suzanë Novobërdaliu** i parashtroi pyetje Kryeministrit të Kosovës lidhur me veprimet për ndërprerjen e punimeve kompanisë “Hidrogjeni” për ndërtimin e dy hidrocentraleve të vogla në lumin Lepenc, afër Kaçanikut.

Kryeministri **Hashim Thaçi** iu përgjigj pyetjes së deputetes Novobërdaliu.

Deputeti **Emrush Xhemajli** i parashtroi pyetje ministrit të Shëndetësisë lidhur me veprimet e kësaj ministrie për t'i plotësuar kërkesat e punonjësve të shëndetësisë, të cilët kanë paralajmëruar grevë për realizimin e kërkesave të tyre.

Ministri **Alush Gashi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Xhemajli.

Deputeti **Hajredin Hyseni** i parashtroi pyetje ministres së Drejtësisë lidhur me hartimin e Projektligjit për personat e pagjetur.

Ministrja **Nekibe Kelmendi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Hyseni.

Deputeti **Driton Tali** i parashtroi këtë pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale: Ka kohë që Trusti i Kursimeve Pensionale shënon rënie në vlerë për shkak të trazirave financiare. Edhe sa kohë duhet të presin kontribuuesit dhe subjektet afariste që ju të ndërmerrni nismë për ndryshimin e Rregullores ekzistuese?

Ministri **Nenad Rashiq** tha se nuk e ka marrë më parë pyetjen. Përgjigja mbetet për seancën tjetër.

Deputetja **Sanije Aliaj** i parashtroi pyetje ministres së Drejtësisë lidhur me shkeljen e të drejtave të njeriut të të burgosurve në burgun e Dubravës.

Ministrja **Nekibe Kelmendi** iu përgjigj pyetjes së deputetes Aliaj.

Deputeti **Shkumbin Demaliaj** i parashtroi pyetje Kryeministrit të Kosovës lidhur me veprimet e Qeverisë së Kosovës për t'i kthyer në tregun vendor mjetet financiare, të grumbulluara nga shitja e ndërmarrjeve shoqërore.

Kryeministri **Hashim Thaçi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Demaliaj.

Deputetja **Drita Maliqi** i parashtroi pyetje ministrit të Shërbimeve Publike lidhur me rritjen e pagave dhe pagesën e shujtës për shërbyesit civilë.

Ministri **Arsim Bajrami** iu përgjigj pyetjes së deputetes Maliqi.

Deputetja **Teuta Hadri** i parashtroi pyetje ministrit të Shëndetësisë lidhur me tatimin e 20% nga pagesa e kujdestarisë për punonjësit e shëndetësisë.

Ministri **Alush Gashi** iu përgjigj pyetjes së deputetes Hadri.

Pyetjet të cilat nuk u parashtruan në këtë seancë për shkak të kohës së kufizuar (50 minuta), procedohen në seancën e radhës.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për masat antidamping

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta prezantojë Projektligjin për masat antidamping.

Ministri i Tregtisë dhe i Industrisë, **Lutfi Zharku**, tha se arsyeja për nxjerrjen e këtij projektligji është se kjo fushë deri tani nuk ka qenë e rregulluar me ligj. Me këtë projektligj përcaktohen rregullat për procedurat, kushtet e përcaktimit dhe të zbatimit të masave antidamping dhe kundërbalancuese, me qëllim të mbrojtjes së industrisë dhe prodhimit vendor në rastet kur dëshmohet dhe pengohet nga praktikat jolojale të tregtisë ndërkombëtare përmes importeve të dampuara ose të subvencionuara.

Projektligji vendos një kornizë gjithëpërfshirëse ligjore në përputhshmëri me normat dhe direktivat, sipas Organizatës Botërore të Tregtisë, si dhe me praktikat dhe legjislacionin e Unionit Evropian.

Struktura e Projektligjit përmban 11 kapituj:

Dispozitat e përgjithshme përcaktojnë dampingun si masë e cila zbatohet për produktet që janë objekt i dampingut, importimi i të cilave në tregun e Republikës së Kosovës shkakton ose kërcënon t'i shkaktojë dëm industrisë për të vazhduar më tutje me përcaktimin e subvencionimit si masë kundër balancuese.

Me rastin e vlerësimit të dëmit të shkaktuar nga dampingu, Ligji përcakton mekanizmin përmes të cilit themelohet Komisioni për vlerësimin e masave për importet e dampuara ose të subvencionuara.

Me synimin që shteti i Kosovës në një të ardhme të afërt të anëtarësohet në OBT, e cila është e vetmja organizatë ndërkombëtare që merret me përcaktimin e rregullave të funksionimit të tregtisë ndërmjet vendeve anëtare, duke pasur parasysh rëndësinë që paraqet ky ligj për Republikën e Kosovës në lëmin e ekonomisë dhe të tregtisë, në përgjithësi, si dhe me qëllim të mbrojtjes së industrisë dhe të prodhimit vendor, në veçanti, i rekomandoj Kuvendikt që ta miratojë Projektligjin për masat antidamping.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin në parim, të Projektligjit për masat antidamping.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime në Projektligjin për masat antidamping dhanë: në emër të Komisionin Funksional, **Myzejene Selmani**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Sala Berisha**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Sabri Hamiti**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Riza Smaka**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Synavere Rysha**, në emër të Grupit Parlamentar "7+", **Xhezair Murati** dhe në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, **Radmila Vujovic**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 68,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi njëzëri miratoi, në parim, Projektligjin për masat antidamping.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Ekonomi, Tregti dhe Industri – si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion e Gjyqësi, Komisionin për Buxhet e Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për bujqësi dhe zhvillim rural

Ministri i Bujqësisë nuk ishte i pranishëm në seancë për ta arsyetuar Projektligjin. Shqyrtimi i tij u shty për seancën e radhës.

5. Shqyrtimi dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbështetje ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nr. 02/L-5

Kryetari i informoi deputetët lidhur me procedurat e shqyrtimit të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbështetje ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe me raportet e komisioneve të përhershme parlamentare dhe të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, si komision përgjegjës dhe raportues.

Ai ftoi përfaqësuesin e komisionit raportues që ta arsyetojë Raportin dhe rekomandimet para deputetëve të Kuvendit.

Deputetja **Safete Hadërgjonaj**, në emër të komisionit funksional e prezantoi raportin e komisionit para deputetëve të Kuvendit dhe i ftoi që atë ta miratonin. Ajo pati vërejtje në stafin mbështetës të këtij komisioni gjatë përgatitjes së raportit. Ajo ftoi deputetët që ta miratojnë raportin dhe amendamentet e paraqitura nga komisioni funksional.

Kryesuesi i seancës, **Eqrem Kryeziu**, hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13 dhe 14.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 63;
Kundër----- 2.
Abstenime-----5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbështetje ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

6. Shqyrtimi dytë i Projektligjit për Noterinë

Kryesuesi i njoftoi deputetët lidhur me procedurat e shqyrtimit të Projektligjit për Noterinë, si dhe me raportet e komisioneve të përhershme parlamentare dhe të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision përgjegjës dhe raportues.

Ai ftoi përfaqësuesin e komisionit raportues që ta arsyetojë Raportin dhe rekomandimet para deputetëve të Kuvendit.

Kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, **Bahri Hyseni** prezantoi raportin e komisionit para deputetëve të Kuvendit. Ai pati vërejtje në përkthimin e një amendamenti në gjuhën serbe, nga ana e shërbimit të përkthimit. Ai ftoi deputetët që ta miratojnë raportin me amendamente të komisionit funksional.

Kryesuesi hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30 dhe 31.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 59;
Kundër----- 0.
Abstenime-----5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për Noterinë.

7. Miratimi i Rekomandimeve të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor që t'i arsyetojë rekomandimet para deputetëve të Kuvendit

Kryetari i Komisionit funksional, **Lulzim Zeneli** prezantoi rekomandimet e komisionit dhe i ftoi deputetët që t'i miratojnë.

Kryesuesi hodhi në votim rekomandimet e këtij komisioni. Rezultatet e votimit ishin, si vijon:

Për-----59,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

I. Miratohen rekomandimet e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor lidhur me gjendjen në pyjet e Kosovës, si vijon:

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, me Vendim të ndërpresë përkohësisht të gjitha aktivitetet legale që ndërlidhen me prerjen e pyjeve në Kosovë, veçanërisht në komunën e Deçanit, (anulimi i tenderit për prerje të drunjve).
2. Qeveria e Republikës së Kosovës, respektivisht MBPZHR urgjentisht të përgatisë planin menaxhues afatgjatë për pyjet e Kosovës.
3. Qeveria e Republikës së Kosovës të fillojë procedurën për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pyjet (L.nr.2003/3) në pajtim me politikat e Qeverisë së Kosovës.

4. Qeveria e Republikës së Kosovës të iniciojë procedurën e ristrukturimit të Njësisë së Rojeve të Pyjeve, në përputhje me nevojën dhe gjendjen e krijuar në Kosovë.
5. Qeveria e Republikës së Kosovës të filloi procedurën për krijimin e lehtësirave doganore për importuesit potencial të drurit, dhe
6. Qeveria e Republikës së Kosovës të kërkojë nga Gjykatat në Republikën e Kosovës që shqyrtimi i lëndëve që ndërlidhen me dëmtimet e Pyjeve në Kosovë, të ketë prioritet.

8. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për revizionin e brendshëm, nr. 02/L-74

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e komisionit për Buxhet dhe Financa që ta arsyetojë raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për revizionin e brendshëm para deputetëve të Kuvendit.

Kryetari i Komisionit Funkcional, **Gani Koci**, tha se Ligjit për auditimin e brendshëm ka të bëjë më shumë me Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave. Konsideroj se është më se e nevojshme dhe më se e domosdoshme që të jetë ministri i Ekonomisë dhe i Financave gjatë shqyrtimit të këtij raporti. Por, ministri nuk ishte i pranishëm në seancë, ishte në udhëtim zyrtar jashtë vendit, andaj ai propozoi që shqyrtimi i këtij raporti të shtyhet për seancën tjetër, kur të jetë i pranishëm edhe ministri Shala.

Kryesuesi kërkoj deklarimin e kryetarëve të grupeve parlamentare. Përfaqësuesit e të gjitha grupeve parlamentare mbështetën propozimin e kryetarit të Komisionit për Buxhet, Gani Koci, për ta shtyrë këtë pikë për seancën e radhës.

Kuvendi, me votim të hapur miratoi propozimin që Raporti për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për revizionin e brendshëm të shtyhet për seancën e radhës.

9. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për zbritjen e tarifës menaxhuese,

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e komisionit për Buxhet dhe Financa që ta arsyetojë rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa para deputetëve të Kuvendit.

Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, **Gani Koci** prezantoi rekomandimin e komisionit dhe i ftoi deputetët që ta miratojnë kërkesën e Trustit të Kursimeve Pensionale për ulje të tarifës nga 0.90% në 0.80% për vitin 2009.

Kuvendi, pas diskutimeve të deputetëve: **Ramë Buja, Sabri, Hamiti, Shkumbin Demaliaj, Ardian Gjini, Synavere Rysha, Xhezair Murati, Radmilla Vujoviq, Naim Rustremi, Driton Tali, Fatmir Rexhepi, Riza Smaka, Berim Ramosaj, Gani Buçinca, Ahmet Isufi, Bahri Hyseni dhe Armend Zemaj**, të cilat ishin shumë përmbajtësore dhe kritike lidhur me kërkesën e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Trusti i Kursimeve Pensionale që Kuvendit të Kosovës t'ia paraqesë një **analizë me arsyetim** për zbritjen e tarifës vjetore menaxhuese prej 0.90% në 0.80% të mjeteve për financimin e operacioneve të Trustit, e cila do të shqyrtohet në seancën tjetër të radhës.

Në vazhdim, seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit.

10. Njoftimi i grupeve parlamentare të LDK-së dhe të AKR-së për ndërrimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare

Kryetari i njoftoi deputetët me vendimin e Grupit Parlamentar të LDK-së, që anëtar në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi të emërohet deputeti Armend Zemaj, në vend të deputetit Lutfi Haziri, si dhe me vendimin e Grupit Parlamentar të AKR-së që anëtar i Komisionit për Buxhet dhe Financa të emërohet deputeti Riza Smaka, në vend të deputetit Behxhet Pacolli, ndërsa në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi të emërtohet deputeti Ibrahim Makolli, në vend të deputetit Riza Smaka.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 17:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale